

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për krime të rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fillim Skoro, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Have Haliti, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarit N.M., për shkak të veprës penale marja e ryshfetit, nga neni 343 par.2 të KPRK-ës, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.216/13 të datës 21.05.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **10. gusht 2018**, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**REFUZOHET** si **e pabazuar** ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.216/13 të datës 21.05.2018, **VËRTETOHET**.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës themelore në Prishtinë me aktgjykimin PKR.nr.216/13 të datës 21.05.2018, ndaj të akuzuarit N.M. në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK-së është refuzuar akuza për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Gjithashtu është vendosur që shpenzimet e procedurës penale lidhur me këtë çështje penale të mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

I dëmtuari M.A. nga Podujeva për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokuroria Themelore në Prishtinë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendje faktike, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë të anulohet dhe çështjen t'i'a kthejë Gjykatës se shkalles së parë në rigjykim dhe vendosje.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u shjarruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, me shkresën e vet PPA.I.nr.296/18 të datës 27.06.2018 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë ta aprovoj si të bazuar, ashtu që aktgjykimin e atakuar ta anuloj dhe çështjen t'ia kthej Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje

Gjykata e Apelit e Kosovës, konform nenit 394 par.1.të KPPK-së shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, si dhe pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe gjeti se:

#### **-Ankesa nuk është e bazuar.**

Sa i përket pretendimeve ankimor lidhur me shkeljet esenciale te dispozitave te procedurës penale nga neni 384 par.1.ner par.1.12, te KPRK-se, prokuroria pretendon se aktgjykimi i gjykatës se shkallës se pare nuk përmbajnë faktet vendimtare me te cilat Gjykata e ka mbështetur aktgjykimin e saj nga fakti se konsideron se gjykata nuk ka bere drejte rikualifikimin e veprës penale marrja e rryshfetit nga neni 343 par.1. ne veprën penale marrja e rryshfetit nga neni 343 par.2. te KPK-se e si pasojë e secilës ka ardhë deri te shkelja e ligjit ne favor te akuzuarit për qka është refuzuar akuza nga arsyeja e ricilsimit te veprës penale e ne baze se cilës ka arritur parashkrimi i ndjekjes penale.

Gjykata e Apelit ka bere vlerësimin e pretendimeve ankimore te Prokurorisë Themelore ne Prishtine dhe pas vlerësimit te njëjtës konstatojmë se ankesa nuk është e bazuar.

Prokuroria e ka akuzuar N.M.n se ne cilësinë e personit zyrtare ne Kompanine NEWCO Feronikeli Kompleks LLC, ne Drenas, nga i dëmtuari M.A. ka kërkuar një veture, si dhurate, me qellim te përfitimit për vete, si kusht për ta realizuar kontratën qe me pare e kishte lidhur me Kompaninë e lartpërmendur, me qka e ka kryer veprën penale marrja e rryshfetit nga neni 343 pr.1. te KPK-se.

Gjykata e Apelit te Kosovës vlerësoj, pretendimet ankimore dhe shkresat te tjera ne lende dhe gjeti se Gjykata e shkalles se pare me vend ka vepruar kur ka bere ricilsimin e veprës penale nga marrja e rryshfetit nga neni 343 par.1. te KPK-se, ne veprën penale marrja e rryshfetit nga neni 343 par.2. te KPK-se, e si pasojë e secilës edhe është refuzuar akuza për shkak te parashkrimit absolut te ndjekjes penale nga se akuzuari akuzohet se vepren penale e ka kryer me 16.01.2010, e për te cilin është i parapare me burgim prej 3 muaj deri ne 3 vjet e ne baze nenit 91. par.6. te KPK-se, ka arritur parashkrimi absolut.

Gjykata e shkalles se pare ka bere ricilsimin e veprës penale nga se ne rastin konkret i akuzuari ka pranuar dhurate për vete veturën e cekur ne aktakuzë për te kryer ne kuadër te autorizimeve te tij nje veprim te cilin është dashur ta kryej, duke patur parasyshe se i dëmtuari M.A. ka lidhur kontratën me Kompaninë dhe e cila kontrate është dashur te zbatohet ashtu siç ka qene e përpiluar dhe se ne rastin konkret veprimet për tërheqjen e materialëve nga Kompania Feronikeli nuk kane qene te ndaluara ashtu siç ka pretenduar Prokuroria ne kualifikimin e saj nga neni 343. Par.1. te KPK-se, e cila paraqet situatën kur akuzuari ka pranuar dhurate ose përfitim tjetër për vete për te kryer ne kuadër te autorizimeve te ti një veprim te cilin nuk do te duhej ta kishte kryer.

Nga kjo del se ne veprimet e te akuzuarit plotesohen elementet e veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 343. par.2. siç ka konstatuar edhe Gjykata e shkalles se pare e për te cilit konstatim e aprovon edhe Gjykata e Apelit e jo siç ka qene i akuzuar për veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 343 par.1. te KPK-se.

Sipas Gjykatës se Apelit, ne rastin konkret Gjykata e shkalles se pare drejt e ka aplikuar edhe ligjin penal kur ka gjetur se ne veprimet te akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 343. par.2. te KPK-se mirëpo e ka refuzuar akuzën nga se për te njëjtën ka rrjedhur parashkrimi absolut i ndjekjes penale, andaj pretendimet ankimore lidhur me shkeljen e ligjit penale ne favor te akuzuarit nuk janë te bazuar.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.315/18, më 10.08.2018**

**Procesmbajtës**  
**Eroll Gashi**

---

**Anëtarët e kolegjit**  
**Abdullah Ahmeti**

---

**Kryetari i kolegjit,**  
**Fillim Skoro**

---

**Hava Haliti**

---